



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11266 Prot

Lezhë, më 31 /07 /2023

VENDIM

Nr. 15, Datë 27. 07. 2023

PËR
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA
FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI TË
Z. PJETËR PRELA, BRENDA TERRITORIT TË BASHKISË LEZHË.

Bazuar në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë

Vendosi:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes prej **0.9 ha** në pronësi të **Z. P. P**, në pasuritë 552/6, 351/11 dhe 351/7, ngastra pyjore 50, ish pjesë e ekonomisë pyjore "Mali i Rrencit", sipas Raportit Tekniko-Ekonomik bashkëlidhur.
2. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku do të ndërtohet, bëhet nga shoqëria "GJERGJI"sh.p.k brenda 1 (një) viti nga koha e përfundimit të objektit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KB
Nr 11266/1 prot
dt. 3.8.2023

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 535/4 Prot.

Lezhë, më 03.08.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr 139/2015 "Për vërtetëqeverisjen vendore", ligjin nr .8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; ligjin nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; VKM-në nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre"; VKM-në nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre (ndryshuar me VKM-në nr. 267, datë 27.4.2023) si dhe në Udhezimin nr. 1 date 26.01.2017, të Ministrisë të Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 15, datë 27.07.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për dhënien e dskordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të z.P.P, brenda territorit të bashkisë Lezhë".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

